



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 112-3389/2023

Klinë datë 26/07/2023

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, dispozitat e nenit 25 të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nr.08/L-017 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.19.2022, Metodologjinë e Planit të Integritetit 2023, si dhe nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, kryetari i komunës së Klinës nxjerr, **ketë:**

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për menaxhimin e përgatitjes
dhe zbatimit të Planit të Integritetit

1. Caktohet Grupi Punues për hartimin e draft Planit të Integritetit, për Komunën e Klinës për periudhën 3 vjeçare, i cili përditësohet nga ana e komunës çdo vit. Përbërja e grupit punues është si në vijim:
 - 1.1. **z. Kreshnik Raci**, koordinator/kryesues;
 - 1.2. **z. Adnan Zeneli**, anëtarë;
 - 1.3. **znj. Vlora Tafili**, person përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit;
2. Obligohet grupi Punues të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, përmes së cilit do të informojë punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e hartimit të Planit të Integritetit, do të vlerësojë gjendjen aktuale të funksionimit të institucionit dhe do të analizojë masat ekzistuese për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit, do të vlerësojë intensitetin e rrezikut të korrupsionit, do të propozojë afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e masave përmirësuese që ulin rrezikun e korrupsionit, si dhe do të informojnë punonjësit për situatën në institucion duke vlerësuar intensitetin e rrezikut të korrupsionit dhe planin e zbatimit të masave përmirësuese. Grupi Punues sipas nevojës mund të përfshijë punonjës të tjerë të institucionit në hartimin e Planit të Integritetit.
3. Grupi punues përfundon hartimin e draft Planit të Integritetit në një afat sa më optimal.
4. Përgjegjës për miratimin e Planit të Integritetit është Kuvendi i Komunës së Klinës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara më Ligjin, Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit. Prandaj, duke e marrë parasysh rëndësinë dhe qëllimin e hartimit dhe të miratimit të Planit të integritetit, si një dokument i cili paraqet rezultatin e vetëvlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit, qëllimi i të cilit është të ruajë dhe përmirësojë integritetin e

institucionit duke thjeshtuar procedurat, duke forcuar llogaridhënien, kontrollin e kompetencat diskrecionale, edukimin, forcimin e etikës, krijimin e një sistemi efektiv kontrolli dhe eliminimin e praktikave joefikase. Grupi punues si në pikën 1 të dispozitivit të këtij Vendimi, është përgjegjës që gjatë punës së tij të ketë parasysh të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara si në pikën 2 të dispozitivit, si dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe procedurave standarde të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, kjo me qëllim të krijimit të një mekanizmi institucional, i cili do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit të institucionit. Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Te njoftohen:

- Anëtarët e grupit punues;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;
- Drejtoritë komunale,
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Komuna e Klinës
Kryetari,
Zenun Elezaj

